



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:028552

Datë: 24.01.2024

Numri i dokumentit: 05230977

AA.nr.153/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështja Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses A... L... nga Gjilani, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.423/2020 të datës 12.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 28.12.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses A... L... nga Gjilani,, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.423/2020 i datës 12.01.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.423/2020 të datës 12.01.2023, është refuzuar si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses A... L... nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës me seli në Prishtinë, me numër të protokollit: 03/2489/19 i datës 13.01.2020).

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësjja, të cilën e përfaqëson me autorizim Sh...Sh. I... avokat nga Gjilani, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave procedurale të Ligjit për Konfliktet Administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aprovohet si e bazuar ankesa. Ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkalles së parë të ndryshohet, ashtu që të anulohet aktvendimi i të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, me nr. 032489/2019, i datës 10.01.2020 si i kundërligjshëm

dhe i pabazë, dhe paditëses ti lejohet bartja e pronësisë së njësisë kadastrale- banesës nr. 0-71914059-07577-2-379-2-38-0, ne sipërfaqe prej 52.76 m2, pjesën e pronës prej 1/1, e cila gjendet ne ZK në Prishtine, ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të ankimuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Agjencia Kadastrale e Kosovës me aktvendimin me nr. 03/2489/19 të datës 10.01.2020 (Numër të protokollit: 03/2489/19 të datës 13.01.2020) e ka refuzuar ankesën si të pa bazuar të parashtruar nga M... L... nga Gjilani, kundër aktvendimit me nr. 011-463-2/2335/18 të datës 24.09.2019.

Paditësja e pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të Agjencisë Kadastrale të Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 19.02.2020, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses, paraqitur kundër aktgjykimit të lartcekur, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditëses e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e aktit të goditur me padi ju referua dispozitave të Ligjit Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe Ligjit nr. 04/1-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, respektivisht neni 3 pika 3.4. Më tutje, gjykata e shkallës së parë ju është referuar nenit 32 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Luftimit të Terrorizmit. Prandaj, nga këto arsye dhe për këtë gjykatë e shkallës së parë tani në këtë gjendje të konstatuar është i pamundur regjistrimi i pronësisë sipas kontratës së lart cituar pasi që nuk janë plotësuar kushtet sipas nenit 3 pika 3.4, nen pika (iii dhe iv) të ligjit Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme. Gjykata e shkallës së parë vlerësoi edhe pretendimet e paditëses se e njëjta ka ofruar dokumentacionin e nevojshëm bazuar në dispozitat e ligjit për bartjen e pajtueshmërisë mirëpo si të tilla këto pretendime meqë nuk janë argumentuar me fakte prova nga paditësja sipas kërkesave të drejtës materiale në zbatim për çështjen nuk u pan me ndikim në një vendosje tjetër nga ajo që ka vendosur e paditura. Andaj, mbi këto arsye kjo gjykatë kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoj sepse sipas vlerësimit të gjykatës nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar Ligjit Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe Ligjit nr. 04/1-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për

Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, respektivisht neni 3 pika 3.4, me të cilin përcaktohet se “3.4 ZKK-ja e refuzon regjistrimin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm, të provojë se parashtruesi i kërkesës është bartës, (iii). nëse validiteti i kërkesës ose ndonjë nga dokumentet mbështetës është në pyetje; dhe (iv) nëse dokumentacioni nuk është i kompletuar dhe nuk paraqet bazë për regjistrim”. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë i është referuar edhe nenit 32 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit me të cilin përcaktohet se: 1. *Kur bartja e të drejtave mbi pronën e paluajtshme përfshin një transaksion ose transaksione në një vlerë monetare dhjetë mijë (10.000) euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj, nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj, secili transaksion duhet të bëhet me anë urdhërpagesës bankare ose transferim bankar.* 2. *Zyra Kadastrale Komunale (ZKK) nuk regjistron transferin e të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme derisa nuk pranon, krahas dokumenteve të tjera që paraqiten në pajtim me ligjin për regjistrimin e transferit, një deklaratë, në mënyrën dhe formën e saktësuar nga NjIF-K e cila vërteton: 2.1. regjistrimin e transferuesit dhe të pranuesit; 2.2. identitetin e secilit prej personave ose subjektit që ka interes financiar dhe i cili është shfrytëzues i pronës që transferohet dhe natyrën e interesit apo statusin e përfituesit; 2.3. çmimin e blerjes dhe mënyrën e pagesës, nëse pagesa bëhet pjesërisht ose tërësisht, duke përfshirë përmes transferit të pronës.*

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurit në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata me aktgjykimin e atakuar nuk ka përfillur fare parashtrimet në padi, provat e bashkangjitura në të dhe deklaratimet e të autorizuarit të paditëses, prova këto që vërtetojnë faktin se Rregullorja e UNMIK-ut nr.2004/2 e datës 01.03.2004 ka rregulluar çështjen mbi pengimin e pastrimit të parave, dhe veprave të ngjashme penale, për periudhën 12 mujore, që konsiston se e njëjta nuk ka qene në fuqi në momentin e vërtetimit të kontratës mbi shitblerjen e banesës dhe e paditura nuk ka mund të refuzoj kërkesën e paditëses për regjistrimin e pronës për shkak të mungesës së transaksionit bankar dhe me vonë të refuzoj ankesën e paditëses. Këto pretendime ankimore ky kolegji nuk i aprovoj, ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e saj janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, sepse vendimi i organit administrativ i të paditurës është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë po ashtu bën zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke ju referuar Ligjit Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe Ligjit nr. 04/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, respektivisht neni 3 pika 3.4, sepse kjo nuk paraqet baze për regjistrimin e pronës, ndërsa në anën tjetër harrohet Ligji Nr.2002/5 dhe Ligji nr. 04/L-009, kanë hyre në fuqi me 01.08.2008 dhe ndryshimi me 10.08.2011, që konsiston se nuk ka të bëjë fare me pronën e paditësit, e as kontratën për shitblerjen të cilat nuk ishin në fuqi, dhe askund nuk përmendet fuqia retroaktive, që të veprojnë ndaj rastit të paditëses. Gjithashtu gjykata bën zbatim të gabuar të së drejtës materiale edhe kur i referohet nenit 32 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit, sepse ky ligj dhe kjo dispozitë ligjore i referohet

kohës kur ka hy në fuqi me 13.06.2016, ndërsa ky ligj nuk ka fuqi retroaktive. Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoj, sepse vlerësoj se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Ngase me nenin 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2004/2 mbi pengimin e pastrimit të parave, dhe veprave të ngjashme penale, pastaj me dispozitën e nenit 27 të Ligjit nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit është si detyrim shtesë për regjistrimin e palujtshmerisë. Ky detyrim gjithashtu është paraparë edhe në kohën e parashtrimit të kërkesës dhe ankesës me nenin 32 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Luftimit të Terrorizmit të Financimit të Terrorizmit. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë së paditëses dhe lënies në fuqi të vendimit të lartpërmendur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.153/2023 me datë 28.12.2023

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi